



**POLICY
ANSWERS**

**SHKURTIMISHT PËR:
DEKARBONIZIMIN DHE
TAKSËN E KARBONIT NË
KONTEKST TË
TRANZICIONIT TË
GJELBËR NË KOSOVË**

Responsible organisation: Riinvest
Institute

Date: July 2023

 <https://www.facebook.com/WBInfoHub>

 <https://x.com/wbinfohub>

 <https://www.linkedin.com/company/wbinfohub/>

www.westernbalkans-infohub.eu

POLICY ANSWERS is funded by the European Commission through the Horizon Europe project "R&I POLICY making, implementation AND Support in the WEsteRn Balkans", Grant Agreement N°10105887.



**Funded by
the European Union**

HYRJE¹

Ndryshimet klimatike dhe pasojat degraduese në ambient, kanë nxitur vendet e zhvilluara për një iniciativë të përmasave globale për të mbrojtur planetin të mos ngrohet më shumë se 1.5°C mbi nivelet para-industriale përmes një caku mjaft ambicioz që synon zero neto emetime të gazrave me efekt serrë deri në vitin 2050. Në këtë kontekst, Evropa është bërë lider global në përpjekjet për adresimin e pasojave të ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e tyre. Lidhur me këtë, në epiqendër kemi nisma ambicioze lidhur me dekarbonizimin e proceseve teknologjike të industrive përpunuese dhe sektorëve tjerë ekonomik. Me një angazhim të vendosur për të kaluar drejt burimeve më të pastra dhe të qëndrueshme të energjisë, vendet evropiane kanë nisur një udhëtim transformues që jo vetëm trajton çështjen urgjente të ngrohjes globale, por gjithashtu përbën një shembull frymëzues për t'u ndjekur për pjesën tjetër të botës. Kësisoj, Bashkimi Evropian është zotuar që do të ulë ndjeshëm emetimin e gazeve serrë, të reduktojnë varësinë nga karburantet fosile dhe të shumëfishojnë pjesën e energjisë së rinovueshme në miksin e tyre energjetik.

Instrumentet fiskale përmes taksës në karbon kanë qenë një prej politikave më të hershme që vendet e ndryshme në botë kanë përdorur në përpjekjet e tyre për reduktim të karbonit. Vlen të theksohet që vendet skandinave kanë aplikuar taksë në karbon qysh në fillim të viteve të 90-ta. Aktualisht janë rreth 40 vende të ndryshme që aplikojnë taksë në karbon ndërsa më e larta aplikohet në Uruguai me një vlerë prej rreth 137 USD për ton karbon të emetuar. Në vendet e Ballkanit Perëndimor, aktualisht vetëm Bosna dhe Hercegovina, Mali i Zi, si dhe Shqipëria kanë vendosur masa të ndryshme në formë të taksave kryesisht në lëndë djegëse fosile. Kosova, sipas Strategjisë së Energjisë 2022-2031, deri në vitin 2025 do të bëjë përgatitjet për vendosjen e një sistemi për përcaktimin e çmimit të karbonit.² Të hyrat e parapara nga taksimi i karbonit me këtë strategji janë të parapara për krijimin e një fondi që do të promovojë investimet në burimet e ripërtrishme të energjisë, përkrahje të konsumatorëve në nevojë si dhe masa të tjera në funksion të një tranzicioni të drejtë.

Një shtyllë kryesore e strategjisë së dekarbonizimit të Evropës ka qenë zgjerimi i shpejtë i burimeve të rinovueshme të energjisë. Energjia e erës, diellore dhe hidrocentralet kanë dëshmuar rritje të jashtëzakonshme, me vendet që investojnë në projekte në shkallë të gjerë dhe stimulojnë vendosjen e teknologjive të pastra. Gjithashtu, në arritjen e qëllimeve të dekarbonizimit janë bërë hapa të rëndësishëm edhe në efikasitetin dhe ruajtjen e energjisë. Tashmë Evropa është bërë një qendër për inovacion në burimet e ripërtrishme,

¹ Publikuar nga Instituti Riinvest. Ky dokument është nxjerrë nga seria e debateve 'Green Talks' në kuadër të platformës Green Action Space, iniciativë e përbashkët e Institutit Riinvest dhe fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), si dhe aktiviteteve në kuadër të projektit "Policy Answers" që implementohen nga Instituti Riinvest. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Institutit Riinvest.

² Strategjia e Energjisë 2022-2031 <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Shqip-Strategjia-e-Energjise-e-Republikes-se-Kosoves-2022-2031.pdf>

duke nxitur përparime në fermat e erës në det të hapur, dhe poashtu ruajtjen e energjisë solare. Për më tepër, programet e rinovimit të ndërtesave, standardet më të rrepta të efikasitetit të energjisë për pajisjet dhe iniciativat që promovojnë transport të qëndrueshëm janë zbatuar në të gjithë kontinentin. Këto përpjekje jo vetëm që reduktojnë emetimet, por gjithashtu rezultojnë në kursime të konsiderueshme të kostos për bizneset dhe ekonominë familjare.

SISTEMET DHE MEKANIZMAT PËR TAKSIMIN E KARBONIT

Angazhimi i palëkundur i Evropës për dekarbonizimin shërben si një dritë shprese në luftën globale kundër ndryshimeve klimatike. Nëpërmjet objektivave ambicioze dhe përpjekjeve bashkëpunuese, vendet evropiane po bëjnë hapa të rëndësishëm drejt një të ardhmeje më të gjelbër dhe më të qëndrueshme. Ndërsa Evropa vazhdon të udhëheqë me shembull, ajo frymëzon vendet tjera në mbarë botën që t'i japin përparësi dekarbonizimit, duke krijuar një rrugë drejt një planeti më të mirë për brezat që do të vijnë. Në këtë aspekt, BE tashmë ka krijuar mekanizmat përmes të cilëve do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e emetimeve përmes skemave dekurajuese për industrinë që emetojnë sasi të mëdha të karbonit. Sistemi i Tregtimit të Emisioneve të BE-së (EU ETS) është një mekanizëm i bazuar në treg i zbatuar nga Bashkimi Evropian për të reduktuar emetimet e gazrave serrë dhe për të luftuar ndryshimet klimatike. Ai është sistemi më i madh i tregtimit të emetimeve në botë dhe mbulon industri të ndryshme, duke përfshirë prodhimin e energjisë, industrinë përpunuese, dhe aviacionin. ETS e BE-së funksionon mbi parimin "vendos kufi të sipërm dhe tregto". Sipas këtij parimi vendoset një kufi në sasinë totale të emetimeve të gazeve serrë që industrinë pjesëmarrëse mund të emetojnë. Ky kufi zvogëlohet gradualisht me kalimin e kohës për të arritur objektivat e reduktimit të emetimeve. Brenda sistemit, lejet e emetimeve u shpërndahen kompanive, ku secila përfaqëson të drejtën për të emetuar një ton CO₂ ose ekuivalentin e tij. Këto kompensime mund të blihen, shiten ose tregtohen lirisht ndërmjet pjesëmarrësve.

Kompanitë që mund të zvogëlojnë emetimet e tyre nën lejet e tyre të alokuara mund t'ua shesin tepricën atyre që tejkalojnë kufijtë e tyre. Në këtë mënyrë kjo krijon stimuj financiar për kompanitë që të investojnë në teknologji më të pastra, masa për efikasitetin e energjisë ose projekte kompensuese apo kreditë ndërkombëtare të karbonit (p.sh. investimi në projekte ambientale kudo në botë). Qëllimi është të inkurajohen reduktimet e emetimeve në mënyrën më kost-efektive duke lejuar që tregu të përcaktojë çmimin e karbonit.

BE-ja vazhdon të përsosë dhe forcojë ETS-në si pjesë e politikave të saj më të gjera për klimën dhe energjinë. Në mënyrë që të adresojë problemin e rrjedhjes së karbonit, BE tanimë ka lansuar edhe mekanizmin e ashtuquajtur CBAM apo Mekanizmi për Rregullimin e Karbonit në Kufi (eng. Carbon Border Adjustment Mechanism) përmes të cilit synon të vendosë një çmim të drejtë për karbonin e emetuar gjatë prodhimit të mallrave intensive

të karbonit që hyjnë në BE dhe për të inkurajuar një prodhim industrial më të pastër në vendet jo anëtare të BE-së. Futja graduale e CBAM është në përputhje me heqjen graduale të shpërndarjes së lejeve falas sipas ETS për të mbështetur dekarbonizimin e industrisë së BE-së. CBAM do të hyjë në aplikim në fazën e tij kalimtare më 1 tetor 2023, e cila do të përfundojë më 31 dhjetor 2025. Seti i rregullave dhe kërkesave për raportimin e emetimeve sipas CBAM do të specifikohet më tej në një akt zbatues për që miratohet nga Komisioni pas konsultimit me Komitetin CBAM, i përbërë nga ekspertë nga shtetet anëtare të BE-së.

CBAM fillimisht do të zbatohet për importet e mallrave të caktuara, prodhimi i të cilëve është intensiv në pikëpamje të emetimit të karbonit dhe gjithashtu përbën rrezik të madh për rrjedhje të karbonit: çimento, hekur dhe çelik, alumini, plehurat artificiale, energjia elektrike, dhe hidrogjeni. Duke qenë se Kosova, përfshirë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, është pjesë e aranzhmaneve tregtare të BE-së, funksionimi i mekanizmave të tillë do të ketë implikime edhe në industritë të cilat tanimë kanë një ekspozim në tregjet e eksportit brenda BE-së. Në fazën e parë, në Kosovë do të preken prodhimi i çimentos, përpunimi i produkteve të ndryshme të hekurit, si dhe prodhimi i energjisë elektrike. Pavarësisht që ekspozimi aktual i produkteve nga sektorët e mësipërm nuk është edhe aq i madh, lista e mallrave të përfshira në këtë mekanizëm do të zgjerohet në të ardhmen duke përfshirë të gjithë sektorin industrial. Gjithashtu, duhet theksuar që gjatë fazës kalimtare bizneset vendore të cilat eksportojnë mallra nga lista e sektorëve të përfshirë do të jenë të detyruara të raportojnë për sasinë e karbonit që emetohet nga procesi i prodhimit për sasinë e eksportuar në BE. Për shkak se rreth 2/3 e emetimeve të karbonit në Kosovë vjen nga termocentralet Kosova A dhe B, dhe përderisa pjesa dërmuese e industrisë furnizohet me energji elektrike nga këto dy termocentralet, burimi i energjisë elektrike do të jetë faktori kryesor që do të ndikojë në rënien potenciale të aftësisë konkurruese të industrisë kosovare në tregjet e eksportit në BE.

SHËNIME PËRMBYLLËSE

Duke pasur parasysh caqet ambicioze që Kosova ka marrë përsipër me Agjendën e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor, dekarbonizimi i ekonomisë do të jetë një nga sfidat më komplekse në funksion të zbatimit të zotimeve të parapara në këtë Agjendë. Përderisa një pjesë e vendeve të rajonit kanë avancuar në jetësimin e masave që kanë për synim uljen e emetimeve të gazrave serrë, në Kosovë ende nuk ka ndonjë strategji të qartë se si ekonomia kosovare do të bëhet neutrale në pikëpamje të ndikimit mjedisor nga aktiviteti i saj ekonomik. Për më tepër, mungesa e kuadrove adekuate dhe ekspertizës teknike brenda institucioneve vetëm se e vështirëson edhe më tej zbatimin e detyrimeve që kanë të bëjnë me adresimin e sfidave në procesin e dekarbonizimit të ekonomisë.

Megjithatë, qeveria, respektivisht ministrinë e linjës, duhet që urgjentisht të ngrisin kapacitetet dhe në mënyrë aktive të angazhohen në përsheptimin e implementimit të zotimeve që lidhen me dekarbonizimin në kuadër të Agjendës së Gjelbër.

Në vijim janë paraqitur edhe disa rekomandime duke u bazuar në vlerësimin e gjendjes sa i përket detyrimeve për dekarbonizimin e ekonomisë:

- Qeveria e Kosovës duhet që urgjentisht të fillojë me përgatitjen e infrastrukturës ligjore për futjen e taksës së karbonit dhe krijimin e stimuljve fiskal për përdorimin e teknologjive të “gjelbra” përfshirë edhe mjetet e transportit plotësisht elektrike.
- Duke pasur parasysh masat e ndërmarra nga BE përmes mekanizmave për taksimin e karbonit si dhe implikimet eventuale që do të kenë edhe në ekonominë e partnerëve tregtar të BE-së, është jetike që në këtë fazë të fillohen përgatitje serioze për një strategji të qartë që përveç dekarbonizimit të sektorit të energjisë, të parashihen edhe masa lehtësuese për sektorin industrial në funksion të rritjes së efikasitetit të energjisë si dhe përkrahjes në investime që kanë për synim pavarësimin gradual nga burimet e energjisë prej burimeve fosile.
- T’u ofrohet përkrahje institucionale dhe asistencë teknike - qoftë edhe përmes angazhimit të ekspertizës nga jashtë - bizneseve që do t’i nënshtrohen masave nga CBAM sa i përket vlerësimit dhe raportimit të emetimeve nga proceset e tyre prodhuese nga tetori i këtij viti.